

MARRËVESHJE

Sot në datë 01 / 03 / 2022, nënshkruhet kjo marrëveshje midis palëve të mëposhtme:

Geri SERJANI, i biri i Florion-it dhe Etlevës, datëlindja 17.11.1995, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, me adresë: Rr. "Jordan Misja", Nd. Hekla, H. 3, ap. 3b, Njësia Administrative Nr. 9, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ID me numër personal J51117051J, dhe

Elona SEVRANI, e bija Hatem-it dhe Edijes, datëlindja 12.06.1978, lindur në Berat, banuese në Tiranë, me adresë: Rr. "Petro Nini Luarasi", pallati Ormos 2000, shk. 1, ap.30, nd. 040, Njësia Administrative Nr. 2, Tiranë, e martuar, me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

Të cilët referohen këtu e në vijim bashkërisht si "Palët", ose veçmas si "Pala".

BAZA LIGJORE:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.
- Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";



DUKE QENË SE:

- Palët kanë lidhur Kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme Nr. 2964 Rep., Nr. 1568 Kol., datë 24.06.2021.
- Objekti i kësaj kontrate shitblerje është shitja e 1 (një) kuote, që përbën 10% të kapitalit të shoqërisë "GO GO TIRANA" SH.P.K., me vlerë totale 350.000 (treqind e pesëdhjetë mijë) Lekë të zotëruara nga ortaku Geri Serjani në dobi të Elona Sevrani.
- Për arsye objektive, ky ndryshim nuk është reflektuar në regjistrin tregtar.

Për sa më sipër, Palët me vullnet të lirë shprehen se:

Neni 1

- 1.1** Objekti i kësaj marrëveshjeje është kryerja e veprimeve të mëtejshme për reflektimin në regjistrin tregtar të shitjes së 1 (një) kuote, që përbën 10% të kapitalit të shoqërisë "GO GO TIRANA" SH.P.K. me vlerë totale 350.000 (treqind e pesëdhjetë mijë) Lekë të zotëruara nga ortaku Geri Serjani në dobi të Elona Sevrani.
- 1.2** Vlera prej 350.000 (treqind e pesëdhjetë mijë) Lekë është likujduar nëpërmjet bankës nga Elona Sevrani për Geri Serjani.




Neni 2

- 2.1 Kjo marrëveshje hartohet, rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.
- 2.2 Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje me vlerë të barabartë ligjore në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

PALËT:


Elona SEVRANI


Geri SERJANI